

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6521
E premte, 28 janar 2022
çmimi 0.40 €

Hovenier: I takon Kosovës të vendosë për Asociacionin

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR SEANCË TË JASHTËZAKONSHME PARLAMENTARE PËR PANDEMINË

FAQE 4-5

OPOZITA: QEVERIA, E PAAFTË TA LUFTOJË PANDEMINË



Deputetët e partive opozitare e kanë kritikuar Qeverinë e Kosovës për paaftësi të menaxhimit të pandemisë Covid-19. Në seancën e jashtëzakonshme parlamentare që është mbajtur të enjten, deputetët e opozitës kanë thënë se, në mungesë të dijes, qeveria ka ndërmarrë masa joadekuate për parandalimin e përhapjes së pandemisë. Sipas tyre, masat e reja kundër Covidit nuk kanë dhënë asnjë rezultat për luftimin e Covidit

AKTUALE



BIDENI PLANIFIKON TA NOMINOJË GRUAN E PARË ME NGJYRË NË GJYKATËN SUPREME

F. 2


THAÇITI I VAZHDOHET MASA E PARABURGIMIT

F. 5

KURTI: BANIMI SOCIAL OFRON MUNDËSI PËR ZHVILLIMIN E KOMUNITETEVE TË REJA

F. 7

EKONOMI



ATK-ja: LIROHENI NGA GJYSMA E GJOBËS TATIMORE NËSE E PAGUANI BRENDA 15 DITËVE

F. 8

SHOQËRIA CIVILE PROPOZON STRUKTURË TË RE TË TARIFAVE TË ENERGISË ELEKTRIKE

F. 8

SPORT



PENSIONOHET ISH-SULMUESI I SHQIPËRISË DHE KOSOVËS, BESART BERISHA

F. 10

KMDLNj: Pse duhet t'u paguhet rryma katër komunave të veriut të Kosovës?

FAQE 7



GJASHTË TË VDEKUR NGA COVIDI NË KOSOVË NË 24 ORËT E FUNDIT

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Polonia nis ndërtimin e murit në kufirin me Bjellorusinë

VARSHAVË, 27 JANAR - Polonia ka filluar ndërtimin e një muri që do të kushtojë rreth 394 milionë dollarë përgjatë kufirit të saj lindor, që synon t'i bllokojë migrantët që vijnë nga Bjellorusia.

Muri me tela gjemborë, i lartë 5,5 metra, do të përkrahë më shumë se 180 kilometra, përgjatë pjesës tokësore të kufirit me Bjellorusinë.

Dy kompani ndërtimi do të punojnë në të gjatë gjithë kohës, duke filluar nga katër lokacione të ndryshme, ndërsa ndërtimi pritet të përfundojë në muajin qershor.

Të enjten (27 janar) gazetarët u lejuan ta shihnin punën në zonën e mbrojtur.

Presioni nga mijëra emigrantë nga Lindja e Mesme dhe Afrika në kufirin ndërmjet Polonisë dhe Lituanisë me Bjellorusinë filloi në verën e vitit të kaluar, duke çuar në përlëshje me rojet kufitare të Polonisë.

Polonia ka mbyllur kufirin e saj me Bjellorusinë, duke përdorur tela gjemborë dhe ka shtuar numrin e rojave kufitare.

Migrantët kryesisht synojnë të shkojnë në Gjermani.

Bashkimi Evropian (BE) thotë se emigrantët po përdoren nga

udhëheqësi autoritar i Bjellorusisë për të destabilizuar bllokun 27-anëtarësh, si hakmarrje për sanksionet e Perëndimit ndaj Minskut, pas zgjedhjeve që nga ndërkombëtarët konsiderohen të manipuluar dhe si shtypje për opozitën.

Si pasojë e temperaturave të ulëta të dimrit, të paktën 12 migrantë kanë vdekur në pyjet e zonës kufitare.

Më shumë se 11 000 migrantë ilegalë kanë hyrë në Gjermani në vitin 2021 përmes Polonisë nga Bjellorusia, ka njoftuar policia gjermane më 27 dhjetor 2021.



Bideni planifikon ta nominojë gruan e parë me ngjyrë në Gjykatën Supreme

WASHINGTON, 27 JANAR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, do ta mbajë premtimin e dhënë gjatë fushatës zgjedhore dhe ta nominojë gruan e parë me ngjyrë në Gjykatën Supreme, tha Shtëpia e Bardhë.

Gjykatësi liberal i Supremes, Stephen Breyer, planifikon që të pensionohet në qershor, njoftuan ligjvënësit. Kjo i jep mundësinë e parë Bidenit që të bëjë ndryshime në gjykatën më të lartë të shtetit.

Pensionimi i Breyerit, 83 vjeç, që ka shërbyer në Gjykatën Supreme që nga viti 1994, nuk do ta ndryshojë balancën ideologjike të gjykatës. Megjithatë, Bideni do të jetë në gjendje të emërojë një juriste më



të re, që mund të shërbejë për dekada të tëra, pasi emërimi në këtë pozitë ka mandat të përjetshëm.

Ish-presidenti Donald Trump, republikan, emëroi tre juristë

gjatë kohës sa ishte në zyrë, duke bërë që gjykata të ketë një shumicë konservative prej 6-3. Zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë, Jen Psaki, tha se Bideni "natyrisht se qëndron" pas

premtimit të bërë gjatë fushatës presidenciale për të emëruar një grua me ngjyrë në Gjykatën Supreme. As Shtëpia e Bardhë dhe as Gjykata Supreme nuk kanë konfirmuar planet e Breyerit për t'u pensionuar, por njoftimi zyrtar pritet të bëhet më 27 janar.

Demokratët do të duhet ta miratojnë emërimin e kandidatës së tyre përmes Senatit, institucion që miraton emërimin e gjykatësve, para zgjedhjeve të Kongresit më 8 nëntor. Demokratët aktualisht kanë një shumicë të ngushtë në Senat dhe mund ta humbin shumicën gjatë zgjedhjeve të ardhshme.

Mitch McConnell, republikani

kryesor në Senat, tha se ai do të bllokojë çdo nominim të Bidenit për Gjykatën Supreme nëse partia e tij rifiton shumicën.

Ndërkaq, lideri i shumicës në Senat, demokrati Chuck Schumer, tha se nominimi i Bidenit për ta zëvendësuar Breyerit do të konfirmohet në Senat "me shpejtësi".

Emërimi i një gruaje me ngjyrë në gjykatë do të bënte që Supremja të kishte katër gjyqtare dhe dy persona me ngjyrë që do të shërbenin në të njëjtën kohë.

Gjykata Supreme ka nëntë anëtarë dhe gjykatësi Clarence Thomas aktualisht është i vetmi gjykatës me ngjyrë dhe i dyti i zgjedhur në historinë amerikane.

Shkencëtarët australianë zbulojnë një objekt "të frikshëm" në Rrugën e Qumështit



CANBERRA, 27 JANAR - Shkencëtarët australianë kanë njoftuar se kanë zbuluar një objekt rrotullues të panjohur në Rrugën e Qumështit, në galaktikën ku gjendet sistemi ynë diellor. Ata pretendojnë se një objekt i tillë nuk është

zbuluar më parë.

Objekti që fillimisht u zbulua nga një student universitar është parë se ka liruar një shpërthim të madh të radio-energjisë, që ka zgatur për një minutë të plotë, dhe ka ndodhur çdo 18 minuta. Objekte që lëshojnë energji në

Univers dokumentohen shumë shpesh. Por, hulumtuesit thanë se është shumë e pazakonshme që një objekt të lëshojë energji për një minutë të plotë. Ekipi i shkencëtarëve ka theksuar se po kryen hulumtime të mëtejme për të kuptuar pse ka ndodhur kjo.

Koreja e Veriut teston edhe dy raketa balistike

PENIANI, 27 JANAR - Koreja e Veriut ka lëshuar edhe dy raketa, që dyshohet se janë balistike, të cilat kanë rënë në det. Nëse vërtetohet se ato ishin raketa balistike, atëherë ky do të ishte raundi i gjashtë i testimeve të armëve gjatë këtij muaji.

Ushtria e Koresë së Jugut ka

njoftuar më 26 janar se raketat balistike me rreze të shkurtër veprimi fluturuan 190 kilometra dhe arritën lartësi prej 20 kilometrash, përpara se të binin në Detin e Japonisë, që njihet edhe si Deti Lindor.

Janë një sërë rezolutash të Kombeve të Bashkuara që ia

ndalojnë Koresë së Veriut që të testojë raketa balistike.

Në muajt e fundit Koreja e Veriut ka kryer teste të raketave të reja. Disa ekspertë thonë se kjo është një përpjekje për të fituar ndikim nga çdo negociatë e ardhshme me Shtetet e Bashkuara dhe me Korenë e Jugut.



Gjashtë të vdekur nga Covidi në Kosovë në 24 orët e fundit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 JANAR - Në Kosovë janë regjistruar gjashtë vdekje dhe 3 917 raste të reja me Covid-19, ka njoftuar të enjten Ministria e Shëndetësisë.

Rastet e reja dolën pas testimit të 15 268 mostrave. Nga kjo shifër i bie se 25.65 për qind e të testuarve kanë rezultuar pozitivë me sëmundjen Covid-19.

Në njoftimin e MSh-së, që u referohet të dhënave të 24 orëve paraprake, bëhet me dije se janë shëruar edhe 617 pacientë.

Në Kosovë aktualisht janë 28 751 raste aktive me Covid.

Gjatë këtyre 24 orëve autoritetet shëndetësore kanë dhënë edhe 4 623 doza të vaksinës kundër koronavirusit.

Deri më tani të vaksinuar plotësisht me dy doza të vaksinës janë 803 638 persona.

Në Kosovë të gjithë personat nga mosha 12-vjeçare mund të vaksinohen kundër koronavirusit.

Në Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (ShSKUK) në trajtim mjekësor janë 181 pacientë, 144 prej tyre të konfirmuar me Covid-19 pozitivë dhe 37 të tjerë post-Covid-19.

Me oksigjeno-terapi janë 98 pacientë, kurse në Mjekimin Intensiv të Klinikës Infektive janë tre pacientë.

Dozën përforcuese dhe atë të tretë mund ta marrin të gjithë

personat mbi 18 vjeç që janë imunizuar me dy doza para tre muajsh.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se Omicron po vazhdon të përhapet me intensitet të lartë dhe është varianti dominues në qarkullim që po rëndon gjithnjë e më tepër situatën epidemiologjike dhe mund t'i ngarkojë institucionet shëndetësore në ditët në vijim me pasoja të rënda për shëndetin e qytetarëve. "Virusi është kudo andaj mos neglizhoni rekomandimet themelore: maskën, distancën, higjienën. Shmangni udhëtimet, qëndroni në shtëpi dhe ajrosni ambientet e mbyllura. IKShPK është duke vazhduar pandërprerë testimin dhe gjurmimin e të gjitha rasteve, kontakteve të rasteve në komunitet dhe diagnostikimin laboratorik, andaj të gjithë personat me kokëdhembje, kollitje, dhembje fyti, vështirësi në frymëmarrje, rrjedhje hundësh, temperaturë, plogështi, humbje të shijes, rekomandohen të testohen", ka njoftuar IKShPK-ja.

Sipas këtij instituti, situata epidemiologjike mund të përkeqësohet edhe më shumë në ditët në vazhdim. "IKShPK-ja apelon te të gjithë qytetarët që të respektohen masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Për shkak të rrezikshmërisë së lartë të përhapjes së Covid-19, bëjmë thirrje në veçanti për kujdes dhe



mosgrumbullim. Ndërsa u rekomandojmë institucioneve përgjegjëse t'i mbikëqyrin me përpikëri dhe të ndërmarin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e masave për parandalimin dhe luftimin e pandemisë", ka njoftuar IKShPK-ja, duke shtuar se është i domosdoshëm kujdesi i shtuar i të gjithëve që në mënyrë strikte të respektohet distanca fizike, të përdoret maska, të bëhet dezinfektimi dhe ajrosja e

hapësirave, duke pamundësuar dhe shmangur përhapjen eventuale të mëtejme të infeksionit të Covid-19. "Omicroni është tejet ngjitës, andaj mbani maskat në çdo vend, mbani distancën mbi dy metra edhe në mjedise të hapura edhe po që se të gjithë bartin maska. Duke qenë se vaksinimi është mënyra më e mirë dhe më e sigurt për ta parandaluar Covid-19, veçanërisht formave të rënda të sëmundjes dhe

vdekjeve, ne vazhdojmë të apelojmë fuqishëm për vaksinim sa më gjithëpërfshirës, sa më të gjerë dhe sa më të shpejtë të popullatës nga mosha 12-vjeçare. Vaksinat mund të merren çdo ditë në të gjitha institucionet e kujdesit parësor në komunën tuaj. Gjithashtu, apelojmë për vaksinimin me dozën përforcuese dhe dozën e tretë që mund ta marrin të gjithë qytetarët e moshës mbi 18-vjeçare", ka njoftuar IKShPK-ja.

Hovenier: I takon Kosovës të vendosë për Asociacionin

PRISHTINË, 27 JANAR - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se i takon Kosovës të vendosë se si do të veprojë lidhur me çështjen e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

Në një intervistë për transmetuesin publik, Radio Televizionin e Kosovës, Hovenier ka theksuar se ShBA-ja pret që "Qeveria e Kosovës t'u përmbahet zotimeve që i ka marrë". "Ka modele të cilat ne mendojmë se mund të funksionojnë dhe e kemi inkurajuar Qeverinë e Kosovës që t'i shqyrtojë ato modele dhe ta shqyrtojë atë çështje", ka thënë Hovenier, pa dhënë hollësi mbi këto modele.

Formimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë është pjesë e një marrëveshjeje që është arritur në vitin 2013 në kuadër të dialogut për normalizimin e

marrëdhënive midis Kosovës dhe Serbisë.

Më 2015 palët kanë arritur edhe një marrëveshje për parimet e themelimit të këtij Asociacioni. Por, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka konstatuar se parimet për të nuk janë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, edhe pse ka thënë se ato mund të harmonizohen me një akt ligjor të Qeverisë së Kosovës.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se në Kosovë "nuk mund të ketë asociacion njëetnik".

Pala serbe këmbëngul që Kosova duhet ta zbatojë marrëveshjen për Asociacionin.

Ambasadori Hovenier ka thënë për RTK-në se angazhimi i ShBA-së lidhur me dialogun Kosovë - Serbi është intensiv dhe se në këtë proces ShBA-ja nuk e sheh të diskutueshme çështjen e sovranitetit të Kosovës. "Do të thosha që këto janë fakte historike. Kosova është shtet i



pavarur. Disa njerëz mund të zgjedhin ta kundërshtojnë këtë, por kështu është", ka thënë ai. Hovenier, gjithashtu, ka thënë se ShBA-ja pret angazhim nga

Kosova dhe Serbia për t'i zbatuar marrëveshjet e arritura në Uashington në shtator të vitit 2020. "Ka zotime për personat e zhdukur. Ka zotime për kalimin e

kufirit. Ka zotime lidhur me tregtinë ndërkuftare. Ne besojmë se të gjitha këto do të ishin në dobi të Kosovës dhe të Serbisë", ka thënë Hovenieri.



KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR SEANCË TË JASHTËZAKONSHME PARLAMENTARE PËR PANDEMINË

Opozita: Qeveria, e paaftë ta luftojë pandeminë

Deputetët e partive opozitare e kanë kritikuar Qeverinë e Kosovës për paaftësi të menaxhimit të pandemisë Covid-19. Në seancën e jashtëzakonshme parlamentare që është mbajtur të enjten, deputetët e opozitës kanë thënë se, në mungesë të dijes, qeveria ka ndërmarrë masa joadekuate për parandalimin e përhapjes së pandemisë. Sipas tyre, masat e reja kundër Covidit nuk kanë dhënë asnjë rezultat për luftimin e Covidit

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 27 JANAR - Opozita e ka akuzuar qeverinë se nuk e ka menaxhuar si duhet situatën me pandeminë Covid-19. Deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) kanë thënë se shtimi i rasteve me Covid në këtë muaj tregon për paaftësinë e qeverisë për t'u përballur me pandeminë Covid-19. Sipas tyre, edhe masat e reja kundër Covidit nuk po tregojnë asnjë rezultat për parandalimin e përhapjes së këtij virusi.

Në seancën e jashtëzakonshme parlamentare të thirrur nga partitë opozitare, kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se është brengosëse që Qeveria e Kosovës nuk po shqetësohet për situatën e rënduar me Covid-19. "Kjo qeveri ka bërë dy gabime themelore për menaxhimin e

pandemisë: ose ka hezituar për ta lexuar situatën dhe injoruar atë, ose e ka lexuar situatën gabimisht. Kur hezitojnë të lexojnë, ata hezitojnë të veprojnë në kohë, e kur e lexojnë gabimisht, veprojnë jo me plan, po me impuls", ka thënë Krasniqi. Ai ka thënë se qeveria ka bërë gabime me masat që ka marrë për frenimin e koronavirusit. Sipas Krasniqit, barazia që u është bërë qytetarëve të vaksinuar me ata të pavaksinuarit ka bërë që ta stimulojë mosvaksinimin. "Sot kemi mbyllje të qendrave sportive, ngjashëm si për të vaksinuarit si për të pavaksinuarit. Kufizimi i lëvizjes, përveç që është i panevojshëm, është edhe jologjik", ka thënë Krasniqi.

Edhe deputeti i LDK-së, Armend Zemaj, e ka akuzuar Qeverinë e Kosovës për paaftësi të menaxhimit të situatës me Covid-19. "Gati 30 mijë raste me Covid-19 vetëm gjatë këtij muaji. Ky

është rezultati i menaxhimit online të pandemisë. Ky është rezultat i qeverisjes së paaftë, e që nxjerr masa joadekuate, i neglizhon testimet masive e vaksinimin masiv dhe kujdesin në shkollë. E ul buxhetin për Ministrinë e Shëndetësisë dhe lejon të ketë mungesa të barnave esenciale. Nuk ka koordinim me komunat dhe me shtetet përreth. Kjo qeveri nuk e ka problem t'i hedhë në plehra vaksinat kur ka më së shumti nevojë", ka thënë Zemaj.

Ish-ministri i Shëndetësisë ka theksuar se e vetmja zgjidhje e kësaj qeverie është izolimi, që është duke i dëmtuar bizneset e qytetarët.

"Arroganca, mosveprimi, propaganda janë pjesë e kësaj qeverie. Duke reaguar gjithmonë vonë, e na bënë imunë në situata alarmante, dhe zgjidhjen e vetme e ka izolimin. Shpresojmë që nuk na çojnë edhe në izolim politik. Kryeministri, së fundmi, del thotë

se nuk jam magjistar, por i bën qytetarët fajtorë se kanë besuar në të sa ishte në opozitë. Edhe sot e kësaj dite ne e kemi ditur se magjistar nuk është, por është arrogant dhe me veprimet e tij duket se është magjistar politik. Me ardhjen e kësaj qeverie u rritën të gjitha çmimet, ato ushqimore e deri tek energjia elektrike. Kush i mashtrroi, largoi shqiptarët i pari? Albin akrobati apo magjistari?!", ka deklaruar Zemaj.

Kurse deputeti i AAK-së, Shemsedin Dreshaj, ka vlerësuar se masat që Qeveria e Kosovës ka marrë janë joefektive. Sipas tij, kufizimi i lëvizjes nuk ndihmon në parandalimin e përhapjes së Covid-19. "Shteti përmes aparateve të veta duhet të veprojë me masa sanksionuese për mosrespektim të masave, e jo duke i ashpërsuar me masa shtesë. Shkurtimi i orarit të gastronomisë dhe kufizimi i lëvizjes më tepër i kontribuojnë uljes së shpenzimit të energjisë elektrike sesa menaxhimin të pandemisë. Nuk luftohet pandemia me kufizim të lëvizjes, por me masa shëndetësore", ka thënë deputeti Dreshaj, i cili me profesion është infektolog. Ai i ka rekomanduar Qeverisë së

Kosovës që të testojë më shumë qytetarë dhe të hapë më shumë pika të vaksinimit.

Qeveria mbron masat e reja

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka mohuar kritikën e deputetëve opozitarë për menaxhimin e pandemisë. Ai është shprehur i bindur se masat e reja kundër Covidit do të tregojnë rezultate konkrete. "Si qëllim kryesor i masave është që së paku ta ngadalësojmë rritjen enorme të rasteve të reja sepse nuk mund ta ndalim, por të paktën ta ngadalësojmë. Ne na duhet medoemos ta reduktojmë sa më shumë shpejtësinë e përhapjes së virusit dhe një ngadalësim i tillë u jep mundësi qytetarëve të vaksinohen. Interesimi për t'u vaksinuar po shtohet. Qytetarët po u përgjigjen thirrjeve", ka deklaruar Kurti.

Nga foltorja e Kuvendit ai u ka bërë thirrje qytetarëve që të vaksinohen. "Për shkak të natyrës ngjitëse të Omicronit pritjet që numri të rritet edhe në vazhdim. Pra është si qëllim kryesor i masave të miratuara ta

Këshilli Prokurorial paraqet draftin e planit strategjik 2022-2024

Prishtinë, 27 janar (ER) - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka mbajtur të enjten takim për prezantimin dhe diskutimin e draftit të planit strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024. Në këtë takim, përveç anëtarëve të grupit punues për hartimin e këtij plani, morën pjesë edhe partnerët ndërkombëtarë dhe vendorë, si dhe përfaqësues të shoqërisë

civile, të cilët monitorojnë sistemin prokurorial.

Takimi u hap nga kryesuesi i grupit punues për hartimin e planit strategjik, zëvendëskryesuesi i KPK-së, Veton Shabani, i cili ka falënderuar të gjithë ata që kanë mbështetur draftimin e këtij plani, me theks të veçantë partnerët ndërkombëtarë. Ai ka thënë se drafti i planit strategjik të sistemit

prokurorial 2022-2024 paraqet kornizën kryesore të planifikimit të politikave për menaxhimin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës në tri vjetët e ardhshëm.

Në këtë takim, kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka thënë se qëllimi i këtij plani është realizimi i objektivave të parapara, me ç'rast në fokus të veçantë të

kësaj strategjie janë vënë edhe ndëshkimi i korrupsionit, krimi të organizuar dhe i disa veprave të tjera penale që, faktikisht, mbajnë peng edhe zhvillimin e vendit dhe janë shumë të rëndësishme edhe në proceset e integritetit në Bashkimin Evropian.

Kryesuesi i KPK-së, Jetish Maloku, ka theksuar se plani strategjik paraqet një kornizë të gjerë të

veprimtarisë së sistemit prokurorial, duke u mbështetur në praktikën më të mira vendore dhe ndërkombëtare. Ai ka shtuar se në këtë dokument janë vlerësuar edhe sfidat dhe rreziqet që mund të paraqiten gjatë zbatimit në praktikë, sidomos ato që kanë të bëjnë me reforma në sektorin e drejtësisë, përkatësisht me ndryshimet ligjore.



Thaçit i vazhdohet masa e paraburgimit

HAGË, 27 JANAR - Shefja e informimit dhe komunikimit publik në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK), Angela Griep, nëpërmjet platformës online "Zoom", ka bërë me dije të enjten se Gjykata Speciale ia ka vazhduar masën e paraburgimit ish-presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi.

Griep ka dhënë informacione të përditësuara mbi zhvillimet e fundit lidhur me procedurat gjyqësore dhe veprimtaritë në këtë gjykatë. Ajo ka thënë se në rastin Thaçi dhe të tjerët, të martën, më 25 janar, një version i redaktuar publik i vendimit i gjykatësit të procedurës paraprake është dorëzuar, me të cilin

urdhërohej mbajtja e mëtejme në paraburgim e Hashim Thaçit. "Gjykatësi i procedurës paraprake konstatoi që rreziku se i akuzuari t'i pengojë procedurat ose të kryejë krime të tjera mund të zbutet mjaftueshëm përmes kornizës për monitorimin e komunikimit të objekteve të paraburgimit të Dhomave të Specializuara", ka thënë Griep. Më tutje, ajo ka bërë me dije se më 21 janar trupi gjyqësor ka urdhëruar mbajtjen e mëtejshme në paraburgim të Salih Mustafës. Sipas saj, gjykatësit kanë konstatuar se rreziku i pengimit të ecurisë së procedurës vazhdon të ekzistojë, përfshirë rrezikun e ndërhyrjes në viktima dhe dëshmitarë.



ngadalësojmë rritjen enorme të rasteve, se nuk e ndalim dot. Ngadalësimi do të bëjë që sistemi shëndetësor të mos mbingarkohet menjëherë", është shprehur Kurti.

Edhe ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, i ka arsyetuar masat e reja kundër Covidit në Kosovë.

"Ashtu siç kemi pritur, dje kemi arritur mbi 4 000 të infektuar e numri i të vdekurve ka kaluar 3 000. Ashtu siç kam thënë dje, numri është diçka e re. Pavarësisht prej numrit të infektuarve, numri i atyre që kërkojnë ndihmë në spitale është i ulët e i menaxhueshëm në

sistemin e brishtë të ne. Jemi duke e trajtuar situatën epidemiologjike. Edhe unë mendoj sikur Dreshaj, se mjekët e infermierët që po merren me kujdesin për ta parandaluar shpërndarjen e virusit janë heronjtë tanë. Të gjitha vendimet që merren për çfarëdo mase janë

diskutime të gjata, edhe me profesionistë shëndetësorë, edhe nga IKShPK-ja, edhe nga grupi këshillëdhënës i MSh-së", ka deklaruar ai.

Numri i rasteve me Covid ka filluar të rritet nga fillimi i vitit të ri, kur është konfirmuar prania e variantit të ri Omicron, i cili ka

aftësi shpërndarëse shumë më të madhe se varianti Delta. Vetëm në 24 orët e fundit Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se janë regjistruar gjashtë persona të vdekur dhe 3 917 raste të reja. Brenda një muaji numri i rasteve aktive me Covid ka shkuar rreth 30 mijë.

Drejtoresha për Kulturë në Mitrovicë premtan angazhim për të rinjtë

MITROVICË, 27 JANAR (ER) - Drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, Valdete Idrizi, ka pritur të enjten në takim zëvendëskryesuesen e

Kuvendit Komunal të Komunës Veriore të Mitrovicës, Skender Sadiku. Në këtë takim ata kanë biseduar lidhur me mundësitë e bashkëpunimit

rreth aktiviteteve të përbashkëta kulturore dhe sportive, me fokus të veçantë për të rinjtë. Në fund të këtij takimi drejtoresha Valdete

Idrizi ka theksuar se do të angazhohet maksimalisht për të rinjtë e Mitrovicës, pasi që është një nga prioritetet kryesore të qeverisjes.



Vendimmarrësit e Gjilanit themelojnë 11 trupa ndihmëse të Kuvendit

GJILAN, 27 JANAR (ER) - Kuvendi Komunal i Gjilanit, në seancën e thirrur të enjten, ka miratuar vendimin për themelimin e komiteteve dhe numrin e anëtarëve të komiteteve obligative dhe komiteteve të tjera, vendimin për zgjedhjen e anëtarëve të Kuvendit të komunës së Gjilanit në Kuvendin Asociacionit të Komunave të Kosovës si dhe vendimin për themelimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës të Kuvendit për vitin 2022, ndërkaq propozimvendimi për miratimin e orarit të mbledhjeve të Kuvendit dhe Komiteteve është shtyrë për seancën tjetër.

Pas një debati të gjerë rreth formulës së përfaqësimit politik dhe gjinor në komitete, ku pati edhe mospajtime, sidomos nga përfaqësuesi i AAK-së, Nazim

Gagica, Kuvendi Komunal ka votuar për themelimin e 11 komiteteve dhe përbërjet e tyre. Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete, si trupa obligative, do t'i kenë 9 anëtarë, përkatësisht 7, derisa komitetet e tjera joobligative do t'i kenë nga 5 anëtarë.

Kryesuesi i Kuvendit, Arianit Sadiku, ka kërkuar nga subjektet politike që deri të hënën t'i sjellin emrat për secilin komitet, sipas formulës së miratuar për përfaqësim, duke respektuar edhe kriterin gjinor, në mënyrë që këta trupa të bëhen funksionale sa më parë.

Për përfaqësim në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës, Kuvendi zgjodhi Imran Haziri (LDK), Mimoza Kadriun (LV) dhe Bujar Nevzatit (PDK).

Po në këtë seancë është



themeluar edhe grupi punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit, prej 9 anëtarësh

(LDK, LV, PDK dhe G/3), derisa propozim-vendimi për orarin e mbledhjeve është shtyrë për

seancën e radhës, me qëllim të harmonizimit të propozimeve rreth kohës së fillimit të seancave.

Rahimaj: Kamenica njihet për bashkëjetesë të mirë mes komuniteteve



KAMENICË, 27 JANAR (ER) - Kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, ka pritur në takim menaxherin e OJQ "AKC" në Graçanicë, Marko Trajkovic si dhe dy përfaqësueset të kësaj organizate. I pari i komunës ka thënë se Kamenica njihet për bashkëjetesë të mirë mes komuniteteve andaj, sipas tij, bashkëpunimi me këtë organizatë është i mirëpritur. "Një nga vlerat

më të mëdha të Kamenicës është bashkëjetesa ndërmjet komuniteteve, e që besoj se kjo vlerë duhet të jetë model për komunat e tjera. Kjo është si rezultat i institucioneve komunale, por edhe i kulturës qytetare. Andaj është e nevojshme ta bëjmë hapin e dytë që ka për qëllim zhvillim të qëndrueshëm të përbashkët mes komuniteteve. Zhvillimi i përbashkët e forcon

edhe më shumë bashkëjetesën dhe tolerancën, kështu që mirëpres çdo bashkëpunim që ka të bëjë me këtë qëllim", ka thënë Rahimaj.

Edhe menaxheri i kësaj organizate, Marko Trajkovic, u shpreh se është i gatshëm të bashkëpunojë me komunën e Kamenicës, duke zhvilluar projekte që forcojnë edhe më shumë bashkëjetesën në mes të komuniteteve.

Kryetari Latifi ka caktuar ditën e enjte për takim me qytetarë

RAHOVEC, 27 JANAR (ER) - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka caktuar ditën e enjte për takim me qytetarë në zyrën e tij.

Takimet do të mbahen prej orës 13:00 deri orën 15:00. Të enjten Latifi ka pritur qytetarë nga mjedise të ndryshme të

komunës së Rahovecit, me të cilët ka biseduar veç e veç për problemet që i kanë ata. "Takime të ngjashme do të mbahen çdo

të enjte në zyrën e kryetarit Latifi. Qytetarët do të marrin përgjigje në pyetjet dhe kërkesat e tyre", ka njoftuar komuna e Rahovecit.



Inspektorët komunalë kontrollojnë marketet në Malishevë

MALISHEVË, 27 JANAR (ER) - Inspektorët komunalë në Malishevë, në kuadër të punës dhe aktiviteteve të përditshme, edhe të enjten, të shoqëruar edhe nga drejtoresha e Drejtorisë së Inspektoratit, Besartë Kryeziu-Ramaj, i kanë inspektuar marketet në qytetin e Malishevës për zbatimin e masave në përgjithësi, në veçanti për

ndarjet e produkteve ushqimore në rafte dhe afatin e skadimit.

Gjatë injektiveve të realizuara është vërejtur se marketet i zbatojnë masat në përgjithësi, duke përfshirë edhe produktet ushqimore. Gjatë këtij inspektimi u pa se marketet janë duke respektuar masat kundër Covidit. Pavarësisht prej kësaj, drejtoresha e Drejtorisë së

Inspektoratit në komunën e Malishevës, Besartë Kryeziu-Ramaj, u ka bërë thirrje qytetarëve, të cilët hasin në parregullsi gjatë blerjeve në markete dhe dyqane, t'i njoftojnë inspektorët komunalë në mënyrë që cilësia në shërbime të jetë në nivelin më të mirë të mundshëm, pasi mbrojtja e shëndetit të qytetarëve është mbi të gjitha.



KMDLNj: Pse duhet t'u paguhet rryma katër komunave të veriut të Kosovës?

PRISHTINË, 27 JANAR (ER) - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka theksuar se qytetarët e Kosovës po përballen me probleme të mbijetesës për shkaqe objektive dhe subjektive, kurse Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRë), me kërkesë të KEDS-it, operator privat nga Turqia, ka propozuar që çmimi i energjisë elektrike të rritet përtej kërkesave të KEDS-it duke e rrezikuar seriozisht mbijetesën e pjesës më të madhe të qytetarëve të Kosovës. "KMDLNj në shumë reagime ka kundërshtuar këtë rritje të çmimit të rrymës që është e p a r b a l l u e s h m e , diskriminuese, duke ndarë konsumatorët në grupe përfituese dhe ato që do të ndëshkohen sikur që liron nga çdo pagesë katër komunat e veriut të Kosovës, ekskluzivisht sipas parimit etnik. KMDLNj ka paralajmëruar se këto zhvillime do të shkaktojnë pakënaqësi sociale që do të nxitin protesta kundërshtuese, do të ndikojnë në uljen e investimeve shkaku i pasigurisë ekonomike dhe politike, si efekte zinxhiorre të këtyre diskriminimeve. Po bëhet një luftë puro politike midis pozitës dhe opozitës në mungesë të vullnetit për të bërë zgjidhje në interes të qytetarit. Pozita me këmbëngulësi po e mbron ZRRë-në dhe kërkesën për rritje të çmimit të rrymës, kurse opozita po e sulmon

Qeverinë e Kosovës pse po ua paguan rrymën katër komunave të veriut, ndonëse të gjitha qeveritë paraprake e kanë bërë të njëjtin veprim", është thënë në reagimin e KMDLNj-së. Sipas KMDLNj-së, kryetari i Bordit të ZRRë-së para komisionit parlamentar ka deklaruar se katër komuna të veriut nuk janë përfshirë fare në propozimin për rritje të çmimit të rrymës. "...dhe se kur kanë dashur të ndërpresin rrymën për katër komunat e veriut, shumë vite më parë, nga KFOR-i kanë marrë një letër se nuk mund ta bëjnë këtë, prandaj janë detyruar ta vazhdojnë furnizimin për këto komuna. Opinioni kosovar nuk ka qenë i informuar për këtë më parë. Meqë është krijuar një situatë tensionuese dhe një paqartësi për qytetarët e që po manipulohet nga opozita dhe pozita, dhe për ta sqaruar çështjen që do të ndikonte në shtensionimin e gjendjes, KMDLNj kërkon nga qeveritë e mëparshme një sqarim nëse ka pasur bazë ligjore, marrëveshje detyruese të nënshkruar e për të cilën publiku nuk ishte informuar, apo zotim para ndërkombëtarëve ose ndonjë shantazhim që e arsyeton këtë pagesë të rrymës për katër komunat e veriut?! Po kjo pyetje vlen edhe për qeverinë aktuale që po vazhdon ta paguajë rrymën për serbët e veriut të



Kosovës sepse, nëse nuk ka një arsye tepër bindëse, me këtë vazhdim të pagesës po e përligj diskriminimin në baza etnike dhe korrupsionin institucional", është thënë në reagimin e KMDLNj-së. Sipas KMDLNj-së, edhe qeveritë paraprake si dhe qeveria aktuale e kanë detyrim të sqarohen para qytetarëve të Kosovës, ndryshe do të jenë përgjegjës për plaçkitje të qytetarëve të

Kosovës përmes faturimit të fryrë dhe ndarjes së mjeteve për rrymë dhe shërbime të tjera për katër komunat në veri të Kosovës përgjatë 20 vjetëve të fundit. "KMDLNj kërkon përgjigje se kur do të kompensohen qytetarët e Kosovës që janë plaçkitur në periudhën 15-vjeçare përmes fryrjes së faturave dhe se a është marrë në përgjegjësi dikush që e ka planifikuar, nuk e ka penguar

dhe e ka zbatuar këtë plaçkitje", është theksuar në këtë reagim. KMDLNj ka theksuar se e përkrah çdo protestë paqësore që ka për qëllim mbrojtjen e interesit të qytetarit të Kosovës, pa bërë asnjë dallim në asnjë bazë dhe kundërshton çdo protestë që ka qëllime politike duke keqpërdorur dhe manipuluar gjendjen e rënduar ekonomike të qytetarëve të Kosovës.

Kurti: Banimi social ofron mundësi për zhvillimin e komuniteteve të reja

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 JANAR - "Banimi social është infrastrukturë kritike për ta ngritur mirëqenien dhe sigurinë e qytetarëve, për barazi sociale e për t'i fuqizuar dhe zhvilluar komunitetet", ka thënë kryeministri Albin Kurti në hapje të tryezës së rumbullakët për Programin e banimit adekuat social për Kosovë. "Funksioni i banimit social shkon përtej strehimit të njerëzve në nevojë, sigurimit të banimit të përbashkët për komunitetet me të ardhura më të ulëta dhe përmirësimin e mirëqenies së tyre të përgjithshme", ka thënë kryeministri Kurti. Ai ka theksuar se kur projektohet në përputhje me principet e ekonomisë qarkore, duke integruar elementet sociale dhe ato ekologjike, banimi social ofron mundësi për zhvillimin e komuniteteve të reja e të qëndrueshme, mundësi

për inovacion social, zhvillimin e bizneseve lokale dhe promovimin e praktikave qarkore si të prodhimit, ashtu edhe të konsumit. "Është detyrë e jona që në një të ardhme të afërt të krijojmë mundësi për çdo qytetar që ka nevojë, të ketë qasje në shtëpi të sigurt e me cilësi të mirë, me kushtet për jetë të dinjitetshme, zhvillim personal e profesional. Përtej sigurimit të infrastrukturës fizike, programi i banimit do ta përcaktojë edhe rugën tonë të përbashkët drejt qëndrueshmërisë shoqërore, ekonomike dhe mjedisore", ka thënë Kurti.

Ai ka thënë se qeveria është duke punuar në këtë drejtim dhe programi i banimit social parashihet edhe në Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025. Kryeministri ka theksuar se brenda mandatit synojnë ta krijojnë programin për banim social, që do të mundësojë banim të përballueshëm për 4



000 familje. Në këtë tryezë u paraqit dhe u diskutua konceptpropozimi për Programin e Banimit Adekuat

Social për Kosovë, që do të kontribuojë në lëvizjen drejt zbatimit të reformave të nevojshme për zhvillimin e

sektorit të banimit, formulimin e politikave dhe ofrimin e banimit social për qytetarët që kanë nevojë për mbështetje.

ATK-ja: Liroheni nga gjysma e gjobës tatimore nëse e paguani brenda 15 ditëve



PRISHTINË, 27 JANAR (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) njofton se në rast se tatimpaguesi paguan gjobën e shqiptuar brenda afatit prej 15 ditësh atëherë lirohet nga pagesa e 50-përqindëshit të shumës së përgjithshme. Sipas ATK-së, të drejtën për të përfituar e kanë të gjithë tatimpaguesit. "Në rast se tatimpaguesi paguan gjobën e shqiptuar brenda afatit prej 15-ditësh nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit nga Njësitë Organizative për Gjoha dhe Ndëshkime (ZGjoNA), tatimpaguesi lirohet nga pagesa e 50 për qind të shumës së

gjobës së shqiptuar dhe në këtë rast procedura e ankimit suprimohet dhe rasti konsiderohet i mbyllur. Tatimpaguesi i cili nuk paguan gjobën prej 50-përqindësh brenda 15-ditësh, obligohet ta paguajë gjobën prej 100-përqindësh të shumës së përcaktuar me Vendim nga ZGjoNA, ka njoftuar ATK-ja. Administrata thekson se të drejtën për të përfituar nga pagesa e gjobës me zbritje e kanë të gjithë tatimpaguesit, duke filluar nga data 1 shkurt. Po ashtu, ATK-ja ka njoftuar të gjithë tatimpaguesit se deklarimi i të gjitha tatimeve

dhe kontributeve pensionale të aplikuara në vend nga 1 shkurti do të bëhet vetëm në mënyrë elektronike përmes sistemit elektronik EDI. "Për të gjithë tatimpaguesit të cilët ende nuk janë regjistruar në EDI, Administrata Tatimore e Kosovës u bënë thirrje që të regjistrohen sa më parë dhe të përdorin këtë sistem për deklarim. Që nga data 1 shkurt 2022 do ta ndërpresë mundësinë e shkarkimit të formularëve elektronikë për tatime dhe kontribute dhe këto do të mund të deklarohen vetëm përmes EDI", thuhet në njoftimin e ATK-së.

Gazsjellësi amerikan, ambasadori Hovenier: Kosova po bën një studim mjaft të thellë

PRISHTINË, 27 JANAR - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeff Hovenier, duke folur rreth çështjes së refuzimit të gazsjellësit të mbështetur nga Zyra e Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC), ka thënë se Qeveria e Kosovës me të drejtë po bën një studim të thellë për energjinë.

Hovenier në një intervistë për televizionin publik të Kosovës është shprehur se për këto projekte ka afate kohore shumë të rrepta. "Qeveria e Kosovës - e cila me të drejtë po bën një studim mjaft të thellë dhe të kujdesshëm se si mund t'i kalojë më së miri

burimet e saj të energjisë nga një sistem që mbështetet në dy termocentrale ndotëse me thëngjill të epokës jugosllave në një strukturë të shekullit XXI për të siguruar energji - nuk ishte në gjendje të merrte vendime për rrugën e saj të ardhshme në afatet kohore që kërkon MCC-ja. Kjo jodomosdoshmërisht është diçka që po kritikoj. Thjesht, ky është realiteti. Mezi presim që Qeveria e Kosovës të marrë disa vendime përfundimtare për strategjinë e saj energjetike", ka theksuar Hovenier. Sipas tij, procesi i miratimit për këto projekte është mjaft i ndërlikuar.



Shoqëria civile propozon strukturë të re të tarifave të energjisë elektrike

Valuta		EUR	
1.115	ni	2.72	
0.34		3.25	
		2.93	
		4.44	
		0.00	
		0.00	
		2.50	

PRISHTINË, 27 JANAR (ER) - Instituti për Politika Zhvillimore në Kosovë (INDEP) ka propozuar strukturë prej tri blloktarifash të energjisë elektrike. INDEP ndarjen e ka bërë për ata që shpenzojnë nën 600kWh në muaj, ata deri në 1,200kWh dhe për ata mbi

këtë vlerë. "Konsumatorët që do të shpenzonin deri 600kWh në muaj, rritja e çmimit do të ishte 5.5 për qind, për ata deri 1,200kWh për 70 për qind e ata mbi 1,200kWh rritje prej 80-përqindësh të çmimit. Ky propozim është më i ulët sesa ajo që ka propozuar Zyra e Rregullatorit të Energjisë",

ka propozuar INDEP. Kjo organizatë ka thënë se do t'i dërgojë propozimet si komente me shkrim edhe në ZRrE. Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka propozuar që të rikthehen blloktarifat e energjisë duke propozuar që çmimi i energjisë për ata që konsumojnë mbi 600 kWh të dyfishohet.

Borxhi publik në Shqipëri shënon rekord historik

TIRANË, 27 JANAR - Ministria e Financave e Shqipërisë raporton se borxhi publik vlerësohet të ketë arritur në 80.1 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto më 2021, duke shënuar një rekord gjatë periudhës së tranzicionit. Borxhi në këto nivele u rrit pas emetimit të një Eurobondi me

vlerë 650 milionë euro në fund të vitit të kaluar. Të dhënat makroekonomike tregojnë se Borxhi Publik në vlerë pritët të arrijë mbi 1.34 trilion lekë me një shtesë 124 miliardë lekësh [1 miliardë euro] në raport me vitin e pandemisë Covid-19. Borxhi i ri i formuar këtë vit është

mbi 20 për qind e të ardhurave buxhetore të pritshme gjatë vitit 2021. Me herët, gjatë vitit 2021, Banka Botërore lajmëroi se rritja e borxhit publik të Shqipërisë në rekorde historike do ta ulë aftësinë e qeverisë për të shpenzuar në projekte investimesh apo drejtime të tjera pas vitit 2021.



Sa “ruse” është Ukraina?



Nga Olivia DURAND

Një pamflet politik i botuar në vitin 1762, përshkruante një bisedë midis “Rusisë së Madhe” dhe “Rusisë së Vogël”. Gjatë “diskutimit”, kjo e fundit refuzonte të reduktohej thjesht në një pjesë të Rusisë së Madhe, duke qenë e vendosur të paraqiste historinë dhe identitetin e saj unik.

Në atë kohë, emri “Ukrainë” nuk përcaktonte ende një shtet. Por ‘ukraina’, një fjalë që do të thoshte “vend kufitar” në disa gjuhë sllave, ishte përdorur tashmë për të përshkruar territorin e saj të ardhshëm: rajonin e madh të stepave që rrethon lumin Dniepër, dhe që kufizohet me Detin e Zi.

Termi “Rusia e Vogël”, u braktis gradualisht në epokën e nacionalizmit, teksa akademikët dhe mendimtarët ukrainisht-folës të shekullit XIX-të vendosën që ta linin pas termin e vjetër përçmues, për të krijuar idenë moderne të Ukrainës si një komb. Por 2 shekuj më vonë nën udhëheqjen e Vladimir Putinit, Rusia po i shfrytëzon këto diskurse historike për të justifikuar sulmet e saj ndaj Ukrainës së pavarur. Ai i bëri të qarta ndjenjat e tij në një artikull të botuar në korrikun e vitit 2021 në faqen e internetit të presidencës ruse, kur i përshkroi për rusët dhe ukrainasit si “një popull, një tërësi e vetme”.

Kryeqyteti i Ukrainës, është përshkruar vazhdimisht si “nëna e qyteteve ruse”. Kievi ishte në qendër të Rusisë së Kievanit (882-1240), një shtet ortodoks mesjetar, tek i cili e gjurmojnë origjinën e vendit të tyre udhëheqësit rusë, nga Carët e dikurshëm deri tek Putini sot (një

prejardhje e pohuar edhe nga Bjellorusia dhe Ukraina).

Ky pretendim, përdoret shpesh për të mbështetur pretendimet e Rusisë mbi territoret ukrainase. Por ky është një keqkuptim. Ndërsa paraardhësja e perandorisë ruse, Moskovi, u ngrit si pasojë e pushtimit mongol (1237-1240) që shënoi fundin e Rusisë, sundimtarët e Moskës e morën kontrollin e Kievit vetëm 500 vjet më vonë.

Pretendimi mbi origjinën e Kievanit, ishte më shumë një metodë e përshtatshme për të mohuar elementin mongol dhe tatar, që i dha formë zhvillimit të hershëm të Moskovit, dhe në vend të kësaj për t’i dhënë Rusisë një të kaluar ortodokse, me Carët që pretendohesh se ishin emëruar në fron nga vetë Zoti.

Ndikimi territorial i Rusisë mbi mbetjet e Rusisë së vjetër, u kufizua nga Komonuelthi Polako-Lituanëz (1569-1795), një konfederatë e dy fuqive të Evropës Qendrore. Shumica e rajonit të njohur si Ukraina mbeti jashtë autoritetit rus, deri në ndarjen përfundimtare të Polonisë në vitin 1795.

Ukraina është një nga shtetet më të mëdha të Evropës, dhe gjeografia e saj u ndikua nga shumë më tepër sfera sesa vetëm Rusia. Meqë në fillim termi Ukrainë do të thoshte “tokë kufitare”, ky territori gjerë ishte vënë nën shënjestër nga disa mbretëri, jo vetëm nga Rusia, por edhe nga Khanati i Krimesë, Mbretëria e Polonisë dhe perandoritë Habsburge dhe Osmane.

Para vitit 1648, gati të gjithë ukrainasit jetonin nën sundimin e Varshavës. Zona e stepave jugore të Ukrainës, kishte një popullsi të paktë, ndërsa në perëndim Hungaria e kishte sunduar që nga Mesjeta

Transkarpatinë. Ndërkohë qytetet kryesore ukrainase si Lvivi apo Ternopili ishin herë nën sundimin e polakëve dhe herë të tjera të austriakëve.

Këto qytete u bënë për pak kohë qendrat e Republikës Popullore të Ukrainës Perëndimore midis viteve 1917-1921, përpara integritetit të tyre në Bashkimin Sovjetik. Që nga viti 2014, rajoni i Donbasit në lindje dhe bregu i Detit të Zi, kanë qenë në qendër të konfliktit midis Ukrainës dhe Rusisë.

Kjo tokë njihet si “Rusia e Re” (Novorossiya) nga Caresha Katerina e Madhe, kur ushtritë e saj i pushtuan ato në vitet 1770. Por vetëm disa rusë u zhvendosën në “fushën e egër” të Ukrainës jugore (dikoe pole), gjë që nxiti rekrutimin e kolonëve të huaj nga vende të tjera të Evropës. Prandaj “Rusia e Re” nuk ka qenë asnjëherë shumë ruse. Historikisht, territori i saj u banua nga menonitët dhe gjermanë katolikë, nga tregtarë francezë dhe italianë, si dhe nga një numër i madh grekësh, hebrejsh (nga Polonia dhe Ukraina perëndimore), nga bullgarë, serbë dhe sigurisht nga ukrainas. Kur Vladimir Putin i referohet këtij rajoni të madh si “Rusia e Re”, ai ripërdor një keqkuptim të së kaluarës multi-etnike të Ukrainës. Përpyekja për të kuptuar Ukrainën vetëm përmes prizmit rus është kufizuese: identiteti ukrainas është një sintezë e popullsisë së saj multi-kulturore, e cila është e lidhur jo vetëm me Rusinë, por gjithashtu në thelb edhe me shtetet e Evropës Qendrore dhe rajonin e Detit të Zi.

Rritja e lëvizjes nacionaliste ukrainase në shekullin XIX-të, u pa nga autoritetet ruse si një shenjë e ndikimeve të huaja korruptive. Madje ndoshta edhe

si rezultat i një komploti perëndimor. Identiteti ukrainas u karakterizua si i varur nga një kulturë e lartë urbane ruse, teksa gjuha ukrainase lidhej me zonat rurale

Gjuha ruse mbeti një mjet i lëvizshmërisë sociale, pra shumë thelbësore për cilindo që donte të bëhej pjesë e administratës së perandorisë ruse, dhe të përmirësonte statusin e tyre socio-ekonomik. Ende sot në Ukrainë, rusishtja mbetet një gjuhë e përshtatshme për punësim, e përdorur nga shumë biznese dhe industri të teknologjisë.

Gjuha ukrainase flitej shumë kohë përpara botimeve të para të Taras Shevçenkos në këtë gjuhë në vitet 1830. Por alfabeti i tij nuk u standardizua deri në fundin e shekullit XIX-të. Fillimisht, ukrainishtja u inkurajua nga autoritetet cariste si një kundërvënje ndaj ndikimit polak. Por kur u forcuan shoqëritë klandestine ukrainase (Hromady) që kryenin studime dhe kërkime mbi kulturën popullore, qeveria cariste i shpalli në vitin 1876 si të paligjshme të gjitha botimet dhe shfaqjet në gjuhën ukrainase.

Pas vitit 1917, Ukraina përjetoi një “pranverë kulturore” jetëshkurtër për shkak të politikave të indigjenizimit (korenizatsiia) nga bolshevikët. Në fillim këta të fundit inkurajuan përdorimin e gjuhëve kombëtare për të minuar dominimin kulturor rus.

Kështu deri në vitin 1931, 89 për qind e gazetave botoheshin në gjuhën ukrainase, ndërsa atë e mësonin në shkollat 97 për qind e nxënësve. Por Stalini i ndryshoi këto politika në vitin 1932. Zija e bukës, Holodomori, që vrau rreth 3.5 milionë njerëz vetëm në Ukrainë në vitet 1932-1933, shkatërroi atë pjesë vitale të

popullsinë që mundi të ruante shenjat sociale dhe kulturore të një identiteti kombëtar.


Ajo katastrofë e ndryshoi ekuilibrin demografik të vendit, me humbjen e 1/3 së popullsisë së Ukrainës. Lufta e Dytë Botërore shënoi gjithashtu humbjen e së kaluarës së pasur multi-etnike të Ukrainës, me ekzekutimin dhe dëbimin e popullsisë së saj hebreje, dhe gati zhdukjen e plotë të popullsisë etnike tatarë të Krimesë.

Në vitin 1946, në këtë vend kishin mbetur vetëm 25 milionë banorë, dhe kjo e hapi vendin ndaj migrimit në rritje nga pjesë të tjera të Bashkimit Sovjetik, sidomos nga Rusia. Shkatërrimi i shoqërisë ukrainase të paraluftës dhe zëvendësimi i saj me mbështetës të ideologjisë së Rusisë së Madhe, u përforcua nga reforma e gjuhës dhe arsimit e vitit 1958, e cila synonte ta bënte rusishten gjuhën e dytë amtare të të gjithë popujve jo-rusë.

Në kohën e pavarësisë së Ukrainës në vitin 1991, 1/3 e popullsisë përbëhej nga këta emigrantë rusofonë dhe pasardhësit e tyre, sidomos në pjesën lindore industriale dhe në Krime. Deri më sot, Ukraina është shtëpia e popullsisë më të madhe të rusisht-folësve jashtë Rusisë.

Në vitin 1991, 90 për qind e popullsisë votoi pro një Ukraine autonome. Sot, 30 vjet më vonë, Ukraina e sheh veten si një shtet post-kolonial dhe shumëkombësh. As “rus” dhe as si një “Rusi e Vogël”. Ndërsa politikanët rusë vazhdojnë ta cilësojnë Ukrainën si ruse për përfitimet e tyre, kjo pikëpamje e injoron rezistencën e madhe të këtij vendi përballë asimilimit të detyruar, diferencimit kulturor dhe shfrytëzimit kolonial.

! “The Conversation” – Bota.al



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Premtohet spektakël i jashtëzakonshëm për Kupë

PRISHTINË, 27 JANAR - Nga 9 deri më 13 shkurt do të organizohet Final 8 i Kupës së Kosovës. Në konferencën për medie, kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës, Arben Fetahu dhe kryetari i KB, Fatmir Gashi, kanë dhënë hollësi për organizimin e Kupës në Pejë. Fetahu ka premtuar se presin spektakël për Kupë dhe ka treguar pse organizimi i është besuar klubit verdhezi. "Fillimisht ju falënderoj për ardhjen dhe interesimin e madh për këtë konferencë. Jemi shumë të lumtur që Final 8 i Kupës do të mbahet në qytetin e Pejës. Dua të theksoj dy arsye që KB Peja është zgjedhur organizatore. Fillimisht është për nder të Agim Llukës, themeluesit të KB Peja, i cili ka dhënë shumë për basketbollin e Kosovës, si dhe organizimi që do të mbahet në Pejë, që ka munguar në vitet e fundit. Besoj se është koha dhe momenti i duhur që Peja ta organizojë Kupën e Kosovës. Ne

presim spektakël të basketbollit me një organizim të jashtëzakonshëm. Jemi të bindur se KB Peja në bashkëpunim me FBK-në do të organizojnë për mrekulli Final 8 dhe të jetë një festival i basketbollit", është shprehur Fetahu.

Gashi ka shtuar se ky organizim do të jetë i paparë në basketboll dhe model për vitet e ardhshme. "Ne jemi të nderuar që Final 8 do të organizohet në Pejë. Ashtu siç e përmendi Fetahu, për nder të Agim Llukës, si dhe besojmë që do të jetë një organizim i paparë dhe të jetë model për vitet e ardhshme. Pra, mund të krijojmë një standard të ri për organizime të ardhshme. Falënderoj FBK-në për punën që po bën për ngritjen e cilësisë së basketbollit të Kosovës, ku tashmë është një ligë me skuadra të barabarta dhe nuk ka favoritë. Ne presim spektakël nga organizimi, por edhe ndeshje të bukura në parket, pasi

do të kemi ndeshje shumë interesante", ka deklaruar Gashi. Fetahu ka folur edhe për tifozët nëse do të jenë të pranishëm.

FINAL 8	
Meshkujt	
Golden Eagle Ylli - Drita (Grupi A)	
Trepça - Rahoveci (Grupi B)	
Peja - Sigal Prishtina (Grupi C)	
Prizreni 16 - Bashkimi (Grupi D)	
Në ndeshjet gjysmëfinale takohen fitueset e Grupit A-D dhe fitueset e Grupit B-C.	
Femrat	
GJYSMËFINALET	
Penza - Bashkimi	
Prishtina - Trepça	
Liga e Parë meshkujt	
Istogu - Vëllaznimi	
NEW Basket - Vushtrria	




"Ne kemi bërë kërkesë pranë autoriteteve që të lejohen 50 % e tifozëve. Kjo nuk varet nga ne apo nga KB Peja. Kërkesa jonë është që të lejohen tifozët, por gjithnjë duke respektuar masat, të vaksinuar dhe me maska. Gjithashtu, të jemi model edhe në fushatën e vaksinimit. Dua të përmend edhe dy persona shumë të rëndësishëm për këtë organizim e ata janë: Artina

Hasani, Menaxhere e Eventeve në FBK dhe Luan Maloku nga kompania 'Compact Solution', e kontraktuar nga KB Peja për organizimin e Kupës", ka deklaruar Fetahu.

Në fund Gashi shtoi se edhe një konferencë tjetër do të mbahet në Pejë, ku do të shpalohen hollësi të tjera rreth organizimit. Ndeshjet çerekfinale do të zhvillohen më 9/10 shkurt 2022.

Pensionohet ish-sulmuesi i Shqipërisë dhe Kosovës, Besart Berisha

PRISHTINË, 27 JANAR - Ish-sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë dhe Përfaqësueses së Kosovës, Besart Berisha, i ka dhënë fund karrierës së suksesshme. Lajmin e ka dhënë ish-sulmuesi i Prishtinës nëpërmjet një postimi në rrjetet sociale. Berisha i ka falënderuar të gjitha klubet të cilat i ka përfaqësuar, por edhe tifozët për mbështetjen. "Të dashur tifozë, tash ka ardhur koha: Unë do ta mbyll këtu karrierën si futbollist. Ka qenë një periudhë e jashtëzakonshme të cilën nuk do ta harroj kurrë. Më kujtohet kur e fillova karrierën dhe gjithmonë e kisha buzëqeshjen në fytyrën time. Sot po buzëqesh përsëri, duke i menduar të gjitha kujtimet e bukura që i kam pasur në këtë lojë. Në momentin kur nisa të luaj futboll, gjithmonë kam ëndërruar të bëhem futbollist



profesionist. Dua ta falënderoj Zotin që ma mundësoi ta bëj ëndrrën realitet. Dua ta falënderoj familjen për mbështetjen dhe që ka qenë gjithmonë pranë meje. Dua t'i falënderoj edhe të gjitha klubet ku kam luajtur. Ju e bëtë këtë periudhë të jashtëzakonshme për mua. Mezi pres për sfidat e

reja që më presin në të ardhmen e afërt. Do të mbetem gjithmonë i lidhur me futbollin. 1 000 herë faleminderit për kohën që e kaluam së bashku! Do t'ju mbaj gjithmonë në zemër për këtë ndeshje të bukur", ka shkruar ish-përfaqësuesi i Shqipërisë dhe i Kosovës. Ai e nisi karrierën në Gjermani, ndërsa kishte përvoja të tjera edhe në Australi dhe në Japoni. Berisha ka hyrë në histori të futbollit australian si golashënuesi më i mirë atje. Gjatë karrierës, Berisha ka luajtur në liga të forta si ajo gjermane dhe angleze. Ai i ka përfaqësuar ekipet si Tennis Borussia Berlin, Hamburg, Aalborg, Horsens, Burnley, Rosenborg, Arminia Bielefeld, Brisbane Roar, Melbourne Victory, Sanfrece Hiroshima, Western United dhe së fundmi FC Prishtina.

Ministri Çeku priti në takim ish-futbollistin e Shqipërisë, Lorik Cana

PRISHTINË, 27 JANAR - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, e ka pritur të enjten në takim ish-futbollistin e Kombëtares së Shqipërisë, Lorik Cana, me bashkëpunëtorë, të shoqëruar nga drejtuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës, kryetarin Ismet Krasniqi dhe sekretarin Besim Aliti. "Së bashku diskutuan për zhvillimet në fushën e sportit në vend, për krijimin e programeve për masivizimin e sportit me fokus te të rinjtë në shkollat fillore dhe te moshat e reja për identifikimin e talenteve të rinj, edhe për ndikimin që ka në shëndetin mendor dhe fizik aktiviteti sportiv", thuhet në njoftimin e MKRS-së.



Lorik Cana ka thënë se është i

gatshëm të bashkëpunojë me MKRS-në nëpërmjet fondacionit që ka, duke u angazhuar për zhvillimin e programeve për të rinjtë që të merren me sport sa më shumë. Ministri Çeku falënderoi ish-kapitenin e Kombëtares së Shqipërisë në futboll për tërë kontributin e tij sa ishte aktiv në sport si dhe tani me aktivitetet e tjera për ndërgjegjësimin e shoqërisë që të merret sa më shumë me aktivitetet fizike dhe sportive.

Gjuka: Çmimi i më të mirit më motivon ta ndjek ëndrrën

PEJË, 27 JANAR - Qendra e Përfaqësueses së Kosovës dhe Besa Famgas, Egzon Gjuka, është shprehur i lumtur që u vlerësua me çmimin e hendbollistit më të mirë në Kosovë për vitin 2021. "T'ju them të drejtën jetën sportive apo karrierën nuk e kam pasur

shumë të mirë sepse kam pasur disa lëndime shumë të rënda, por unë kam gjetur gjithmonë forcën që të ngrihem, të punoj dhe ta jap më të mirën nga vetja gjatë gjithë kohës. Në fund, munda im u shpaga nga trajnerët të cilët me kanë votuar për këtë çmim. Ky çmim do të

më motivojë që ta vazhdoj ëndrrën time që kam me Kosovën, të arrijmë në ndonjë Kampionat Evropian apo Botëror. Po ashtu, angazhimet e mia me klubin Besa Famgas të vazhdojnë dhe të jemi në garat evropiane sa më lart", ka deklaruar Gjuka.



Reja: Politika nuk ka vend në futboll

Tiranë, 27 janar - Trajneri i Kombëtares së Shqipërisë, Edoardo Reja, së fundmi shprehu solidaritet me presidentin e Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka, pranë shtëpisë të të cilit,

të hënën në mbrëmje, u vendos një eksploziv. Lidhur me ndërhyrjet e fundit të politikës në futboll, Reja theksoi se politika nuk ka vend në këtë sport. "Dua ta shpreh solidaritetin tim të plotë për

presidentin Duka. Nuk më kishte ndodhur kurrë më parë të shihja një incident të ngjashëm të kësaj natyre. Më vjen vërtet keq për Dukën. Kam dëgjuar rreth disa polemikave në Shqipëri, por mund të them që politika nuk ka

vend në futboll. Me Federatën Shqiptare të Futbollit po bëjmë një punë të jashtëzakonshme. Do të ishte mëkat të prishej apo të vihej në diskutim", u shpreh trajneri Reja për gazetën italiane "Corriere Dello Sport".



Numri 1 në botë dhe një surprizë në finalen e Australian Openit për femra

CALABASAS, 27 JANAR - Tenistja australiane Ashleigh Barty dhe ajo amerikane Danielle Collins janë dy finalistet e grand slamit Australian Open, turneu që po zhvillohet në Melburn. Barty, numri 1 në botë, fitoi 2-0 (6-1, 6-3) ndaj amerikanes Madison Keys, një ndeshje që ishte një formalitet për tenisten vendase. Ajo e dominoi sfidën në të dyja setet dhe u kualifikua brenda 60 minutash. Për Barty kjo është hera e parë që kualifikohet në finalen e këtij grand slami, duke u bërë tenistja e parë australiane që shkon në finalen e turneut të shtëpisë. Në gjysmëfinalen tjetër tenistja amerikane Danielle Collins (numri 27 në botë) eliminoi polaken Iga Swiatek, numri 7 në botë. Një rezultat surprizë, pasi polakja konsiderohej favorite,



por fusha tregoi të kundërtën. Collins e pati ndeshjen vazhdimisht nën kontroll, duke i fituar setet 6-4, 6-1. Për Collinsin kjo është hera e parë

që shkon në finalen e një grand slami në karrierën e saj dhe nuk konsiderohet favorite ndaj Bartyt, që do të luajë të shtunën para publikut të vet.

Miami dhe Phoenixi kryesojnë konferencat

MIAMI, 27 JANAR - Kampionët e Milwaukee Bucksit u mundën me rezultat 115-99 nga Clevelandi, një ndeshje e dobët për Bucksin, ku nuk mjaftuan 26 pikët e Antetokounmpos për ta evituar humbjen. Në anën tjetër për Cavaliersin u dallua Love me 25 pikë. Në krye të renditjes në Konferencën e Lindjes qëndron Miami, që fitoi me rezultat 110-96 ndaj New Yorku. Katër lojtarë të Miamit realizuan mbi 20 pikë



(Robinson më i miri me 25 pikë). Fitorja e tetë radhazi për Phoenixin, që mundi 105-97 Utah Jazzin dhe kryeson në Konferencën e Perëndimit. Ndeshje magjike për Bookerin, që realizoi 43 pikë e 12 rebounde. Fiton edhe skuadra e

Chicago Bullsit, që mundi 111-105 Toronton falë 29 pikëve të DeRozanit dhe 23 të LaVines. Zhgënjën sërish Brooklynin, që në fushën e vet u mund 124-118 nga Denveri (Jokiçi 26 pikë e 10 rebounde).

REZULATET

CLEVELAND - MILWAUKEE	115-99
INDIANA - CHARLOTTE	126-158
ORLANDO - CLIPPERS	102-111
ATLANTA - SACRAMENTO	121-104
MIAMI - NEW YORK	110-96
BROOKLYN - DENVER	118-124
CHICAGO - TORONTO	111-105
SAN ANTONIO - MEMPHIS	110-118
PORTLAND - DALLAS	112-132
UTAH JAZZ - PHOENIX	97-105

SHKURT

Gjilani triumfon në miqësore ndaj Shakhter Karagandy

Skuadra e Gjilanit po vazhdon përgatitjet në qytetin bregdetar të Turqisë, Antalya. Skuadra e Ismet Munishit, që është lidere në BKT Superligën e Kosovës, ka zhvilluar ndeshjen e tretë miqësore në tokën turke, ku është përballur me skuadrën nga Kazakistan, Shakhter Karagandy. Gjilanasi kanë triumfuar me rezultat të pastër 2-0 në këtë miqësore. I pari që shënoi ishte Albert Dabiqaj, i cili tundi rrjetën për 1-0 në minutën e 30. Pas tij shënoi Gerhard Progni në minutën e 44-t nga pika e bardhë. Gjilani do të qëndrojë edhe disa ditë në Turqi para se të kthehet për pjesën pranverore të kampionatit.

Scaloni: Messi ka vuajtur shumë nga Covidi, ndaj nuk e ftova

Lionel Scaloni shpjegoi arsyet që çuan në mosthirrjen e Lionel Messit për dy ndeshjet kualifikuese të Kupës së Botës kundër Kilit dhe Kolumbisë. "Ne do të donim që ai të ishte këtu. Unë pata një bisedë me të dhe Leo më tha se ka vuajtur shumë prej Covid. Ai kishte shumicën e simptomave. Është e rëndësishme që ai të rikuperohet fizikisht. Preferova më mirë të mos rrezikoj. Messi nuk ka luajtur prej disa kohësh dhe mendoj se vendimi ishte i duhuri", ka thënë Scaloni. Në mungesë të yllit argjentinas, Scaloni saktësoi se shiritin e kapitenit do ta mbajë Angel di Maria.

City në garë për Dybalan

Disa klube të mëdha në Evropë janë lidhur me nënshkrimin e Paulo Dybala si lojtar i lirë në verë dhe Manchester City tani po konsideron t'i ofrojë argjentinasit një kontratë 10 milionë euro në vit. Pikërisht për atë që thuhet se kishin rënë dakord Juventusit dhe Dybala vetëm disa muaj më parë kur sulmuesi dukej në prag të vazhdimet të kontratës së skaduar me "Zonjën e Vjetër". Liverpooli, Tottenham Hotspuri, Interi dhe Manchester City thuhet se i kanë vënë sytë 28-vjeçarit. Sipas raportit të fundit të "La Gazzetta dello Sport", Pep Guardiola ka kërkuar nënshkrimin e argjentinasit dhe City mund t'i ofrojë atij një marrëveshje prej 10 milionë eurosh në vit, më shumë se çdo ekip tjetër deri më tani.

Haaland: Lewandowski më i miri në botë, pastaj Messi dhe Benzema

Sulmuesi i Borussia Dortmundit, Erling Haaland, ka thënë se tre lojtarët më të mirë në botë për vitin e kaluar janë Robert Lewandowski, Lionel Messi dhe Karim Benzema. "Është një pyetje e mirë. Nëse do të ishte për vitin e kaluar, do të thosha Lewandowski. Po, Lewandowski është i pari, pastaj Benzema, i cili ishte gjithashtu fantastik. Por do të thosha edhe për Messin, i cili ka qenë i jashtëzakonshëm. Pra Benzema dhe Messi do të ndajnë vendin e dytë dhe të tretë", ka thënë Haalandi.

Hardeni paralajmëron largimin në fund të sezonit nga Brooklyn

I ardhur te Brooklyn Netsi një vit më parë me shumë bujë (nga Houston), me shpresën për ta fituar titullin kampion në NBA, basketbollisti James Harden, që njihet me nofken "mjekra", ka mbetur i zhgënjyer nga kjo përvojë. Dy

humbjet e fundit në shtëpi kanë rikthyer pakënaqësitë te Hardeni, që mendon largimin nga Netsi në fund të këtij sezoni. "Të gjithë në skuadër jemi të zhgënjyer nga rezultatet. I dimë aftësitë tona, por për arsye të

ndryshme si dëmtimet, Covid-19 etj., nuk arrijmë të fitojmë dhe të jemi aty ku dëshirojmë. Kjo është zhgënjyese, pasi nuk jemi mirë as fizikisht. E ardhmja ime? Flisni me agjentin tim. Unë dua të fitoj dhe për këtë

erdha këtu, kaq", u shpreh James Harden. Pavarësisht prej zërave për një largim të mundshëm, drejtuesit e Brooklyn Netsit kanë bërë me dije se lojtari nuk do të lëvizë deri në fund të këtij sezoni. Hardeni refuzoi ta

shtyjë kontratën verën e kaluar, por mund ta bëjë këtë gjë verën e ardhshme. Te Brooklyn aktualisht nuk po luan Kevin Durant i dëmtuar, ndërsa Irvingu aktivizohet vetëm në ndeshjet jashtë fushës (i pavaksinuar).



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 53/1
Dt: 27.01.2022

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2021, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

SHPLLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendeve të lira në Qendra e Kompetencës në Skenderaj për vitin shkollor 2021/2022

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vend i lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Skenderaj	Një (1) instruktor/e për lëndet teorike dhe praktike në profilin: Ndërtimtari e ulët dhe Ndërtimtari e lartë (20 orë mësimore)	Vend i lirë
			Një (1) Roje (40 orë pune në javë)	Zëvendësim

Detyrat dhe Përgjegjësitë për Instruktor:

- Instruktori është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e teorisë dhe praktikës profesionale.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të praktikës profesionale dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/a. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për instruktor:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 6 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës së punës;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

Detyrat dhe Përgjegjësitë kryesore për roje:

- Bënë roje të objektit sipas karakteristikave të përcaktuara;
- Siguron objektin e Shkollës sipas kërkesave;
- Monitoron lëvizjen e personave brenda hapësirës së Shkollës;
- Me përgjegjësi të plotë i kryen detyrat e përcaktuara dhe në bashkpunim me të gjithë punëtorët roje;
- Monitoron procesin përmes sistemit të kamerave dhe sistemeve tjera të sigurisë;
- Bashkëpunon ngushtë dhe i përgjigjet personit të caktuar për sigurim të objektit të Shkollës si dhe organet tjera;
- Sipas nevojave të shkollës punëtori do të kryej edhe detyra të tjera.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Diploma e Shkollës së mesme,
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti,
- Kërkohet njohja e punës me kompjuter sistemi i kamerave,
- Kërkohet të ketë trajnime ose certifikata për roje dhe sigurim fizik të objekteve

Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 15 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucionit në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës në Skenderaj.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.

Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Çëndrimi” SH.P.K. me pronar Ali Thaqi, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 70366557, nr. Unik Identifikues: 810395229 si dhe me nr. fiskal: 600049763 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Çëndrimi” D.O.O. pronar Ali Thaqi, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 70366557, nr. Unik Identifikues: 810395229, nr. fis: 600049763, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Çëndrimi” L.L.C. pronar Ali Thaqi has come to the decision to quit its business: 70366557, nr. Unik Identifikues: 810395229 nr. fiskal: 600049763, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgatitjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregatitje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



NJOFTIM PËR KONTRATË- RITENDERIM (Furnizim)

Në përputhje me "Rregullat e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Shtator 2021)"

I Numërtimi i Prokurimit: BQK 22 022.1 121
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës – BQK

II LËNDA E KONTRATËS

II.1.1 Titulli i kontratës i shpallur nga BQK-ja: "Furnizim me licenca tre vjeçare per Nessus dhe Nipper Studio"

III VENDI I REALIZIMIT

III.1 Vendi i realizimit të kontratës: Objekti i BQK-së , rr. "Garibaldi" nr. 33, 10000 Prishtinë.

IV KRITERI PËR DHËNIE TË KONTRATËS

IV.1 "Tenderi i përshtatshëm me çmimin më të lirë" (për më tepër informata referojuni versionit të zgjeruar të njoftimit për kontratë publikuar në www.bqk-kos.org/shpallje/tenderet)

V INFORMATA ADMINISTRATIVE

V.1 Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit dhe informata tjera:

Afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit: 03.02.2022 ora 14:00 në e-mail adresën prokurimi@bqk-kos.org

Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë: 03.02.2022 ora 14:00
V.2 Vendi dhe afati i fundit për dorëzimin e tenderëve:

Adresa: në objektin e BQK-së, Zyra e Arkivit, rr. "Garibaldi" nr. 33, Prishtinë:

Data: 07.02.2022, ora 14:00

V.3 Sigurimi i tenderit: n/a

V.4 Sigurimi i kontratës: n/a

V.5 Takimi për hapjen e tenderëve:

Data: 07.02.2022, ora 14:30. Vendi: Objekti i BQK-së, Rr. "Garibaldi" nr. 33., Prishtinë.

VI INFORMATA PLOTËSUESE

VI.1 Versioni i zgjeruar i njoftimit për kontratë në dispozicion në: www.bqk-kos.org

VII ANKESAT

Në përputhje me "Rregullat e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës", çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë BQK-së brenda afatit prej 5 (pesë) ditëve kalendarike nga shpallja e njoftimit përkatës.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Garibaldi 33, 10000 Prishtinë
www.bqk-kos.org

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Avdyl Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës fillore "Ganimete Tërbeshi" Llukar KK Prishtinë.

► "Rima Engineering Group" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr: 71169790 si dhe nr fis: 601268718.

► Ardian Gashi Gjakovë, shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

